LIGJ
Nr.9767, datë 9.7.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17/1, në fund të pikës 4 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:
"Oficerët e Policisë Tatimore gëzojnë të njëjtat atribute me oficerët e Policisë Gjyqësore.
Procedura e dhënies së këtyre atributeve rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

Neni 2

Në nenin 36 shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:
"ç) kur tatimpaguesi kryen, me lekë në dorë, transaksione shitblerjeje, që kalojnë kufirin e përcaktuar në nenin 36/1 të këtij ligji.".

Neni 3

Neni 36/1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36/1
Arkëtimet dhe pagesat

Tatimpaguesit mund të kryejnë pagesa në cash për blerje mallrash e shërbimesh deri në shumën 300 000 lekë për çdo blerje, por jo më shumë se 10 për qind të totalit të blerjeve gjatë periudhës tatimore. Mbi këtë shumë, pagesat duhet të kalojnë nëpërmjet xhirimeve në llogarinë bankare.
Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull.".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5396, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu